



Raporti përfundimtar mbi analizën e mangësive në zonat e mbrojtura në kuadër të projektit të WWF-it “Zonat e mbrojtura për një planet të gjallë – ekorajoni i Harkut Dinarik”



Ky dokument është përmbledhje e Raportit përfundimtar mbi analizën e mangësive në zonat e mbrojtura në kuadër të projektit të WWF “Zonat e mbrojtura për një planet të gjallë – ekorajoni i Harkut Dinarik” të kryer nga Zyra e WWF-it për Programin e Mesdheut në periudhën qershor - dhjetor 2009. Ai ofron një pamje të përmbledhur të biodiversitetit të ekorajonit të Harkut Dinarik dhe identifikon zonat pak ose aspak të mbrojtura duke mundësuar marrjen e vendimeve më të mira nga menaxherët për planifikimin e rrjetit të zonave të mbrojtura.

Falënderime

WWF falënderon për kontributet e tyre si më poshtë:

Koordinatorët shkencor rajonal:

BSc. Peter Glasnović; Dr. Boris Krystufek; MSc. Andrej Sovinc.

Hartografia:

BSc. Mileta Bojović

Koordinatorët shkencor kombëtar:

Dr. Genti Kromidha, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA);
Dr. Senka Barudanović, Universiteti i Sarajevës, Fakultetit të shkencave natyrore matematikore, Departamenti i Biologjisë, Bosnja - Hercegovina;
MSc. Irina Zupan, Instituti Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës, Kroaci;
Dr. Dragan Roganović, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, Mali i Zi;
BSc. Leon Kebe., Parku rajonal Radensko polje, Sllovenia.

Ekspertët e jashtëm:

Dr. Boris Sket; Dr. Maja Zagmaister; BSc. Borut Štumberger; Dr. Matt Merrifield.

Partnerët e projektit:

Euronatur; TNC (The Nature Conservancy); Universiteti i Primorska, Slloveni.

Në Bosnje-Hercegovinë:

Dragan Kovačević, Banja Luka; Dejan Kulijer, Sarajevë; Ozren Laganin, Banja Luka;
MSc. Tihomir Predić, Banja Luka; Dragan Rončević, Parku Nacional Kozara;
Ivica Udovičić, Sarajevë; Dr. Branko Vučijak, Sarajevë.

Zyra e WWF për Programin e Mesdheut:

Drejtori i Ruajtjes së Natyrës

Dr. Deni Porej

Drejtuese e projektit

MSc. Stella Šatalić

Asistente e projektit

Ivana Korn

Dizajni dhe faqosja

Catherine Roberts

Raporti përfundimtar mbi analizën e mangësive në zonat e mbrojtura në kuadër të projektit të WWF-it “Zonat e mbrojtura për planetin e gjallë – ekorajoni i Harkut Dinarik”, bashkangjitur këtij dokumenti në një CD, është përgatitur nga:

BSc. Peter Glasnović

Dr. Boris Krystufek

MSc. Andrej Sovinc,

BSc. Mileta Bojović,

Dr. Deni Porej

Projekti i WWF-it “Zonat e mbrojtura për planetin e gjallë – ekorajoni i Harkut Dinarik” mbështetet nga Fondacioni MAVA.

Prodhuar nga WWF Programi i Mesdheut, dhjetor 2010.
Shtypur nga Tiskara Zelina në letër 100% të riciklueshme.

Më tepër informacion gjeni në www.panda.org/mediterranean
ose kontaktoni ssatalic@wwfmedpo.org

Çfarë ka të veçantë ekorajoni i Harkut Dinarik?

Bota është gjithnjë më e vetëdijshme për rëndësinë e rajonit të Harkut Dinarik si një prej pikave të nxehta të diversitetit biologjik të Evropës. Peizazhi jashtëzakonisht i fragmentuar, përbërja e larmishme gjeologjike, ndikimi i tipave të ndryshme të klimës dhe depërtimet nga territoret biogeografike fqinje, kane kontribuar se bashku në një diversitet të lartë të zonës. Kjo është favorizuar edhe nga zhvillimi relativisht i ngadalshëm ekonomik dhe mbizotërimi i praktikave tradicionale bujqësore. Pyjet e gjëra dhe të ruajtura mirë ende mbulojnë një pjesë të madhe të kësaj zone dhe i ofrojnë strehim për popullatatave të rëndësishme mishngrënësve të mëdhenjve jetojnë në këto zona, duke përfshirë këtu ariun, rrëqebullin dhe ujkun.

Rajonin shtrihet prej kufirit me Alpet në Slloveni, kalon nëpër Kroaci, pjesës më të madhe të Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, dhe përfundon në veri të Shqipërisë, dhe karakterizohet nga një vargmal qendror që shtrihet deri në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni. I tërë rajoni i Harkut Dinarik karakterizohet nga fenomenet karstike. Erozioni i ujit e ka transformuar shkëmbin amnor gëlqeror në forma karstike sipërfaqësore e nëntokësore, të cilat ofrojnë strehim për disa lloje të veçanta, duke përfshirë edhe një lloj endemik të salamandrës së shpellave *Proteus anguinus*. Sistemi i shpellave paraqet sistemin më të madh të lumenjve nëntokësorë në Evropë, dhe për këtë arsye është burim uji jashtëzakonisht i rëndësishëm për tërë rajonin.

Klima e ngrohtë mesdhetare ka pasur një ndikim të dukshëm në diversitetin e florës dhe faunës në rajonin e Harkut Dinarik. Habitata me ndryshime të konsiderueshme gjenden në largësi të vogla. Mjediset e ujërave të ëmbla kane pasuar një ndikim të madh nga veprimtaria njerëzore, e cila ka ndryshuar si aspektet gjeomorfologjike ashtu edhe biodiversitetin e lumenjve. Një numër i madh i llojeve endemike jeton në rrjedhat e lumenjve të basenit të Adriatikut, ndërsa në rajon si tërësi ekziston një përqendrim i madh i llojeve endemike, ku përfshihen: miu dinarik, lloje të ndryshme të hardhucave, salamandra e shpellës, një sërë jo-rruazorësh, dhe një numër bimësh të cilat kanë gjetur strehim në rrëzat e shkëmbinjve, sidomos në luginat e lumenjve dhe male.

Analiza e mangësive: drejt një këndvështrimi të ri për zonat e mbrojtura

Programi i Punës për Zonat e Mbrojtura në Harkun Dinarik i WWF-it, ka përfunduar se fundmi një analizë të mangësive në zonat e mbrojtura të rajonit. Një prej aspekteve më të rëndësishme të analizës së mangësive është se ofron një perspektivë të re, më të gjerë mbi biodiversitetin e rajonit i cili deri më tani është hulumtuar vetëm në nivelet kombëtare. Identifikimi i zonave pak ose aspak të mbrojtura, mundëson marrjen e vendimeve më të mira gjatë planifikimit të rrjeteve të zonave të mbrojtura.

Analiza e mangësive krahason shpërndarjen e biodiversitetit me sistemet ekzistuese të zonave të mbrojtura, me qëllim identifikimin e zonave në të cilat llojet dhe ekosistemet janë pak ose aspak të mbrojtura. Cilësia e të dhënave në dispozicion për analizë ndryshon ndjeshëm sipas vendeve. Jo të gjitha vendet kishin mundësi të siguronin të dhëna të sakta e gjithëpërfshirëse, dhe kjo është kompensuar nëpërmjet modelimit. Të dhënat e përdorura në analizën e mangësive janë përfaqësuese në nivelin rajonal.

Studiues të ndryshëm e kanë ndare rajonin në disa nën njësi biogeografike, të cilat kryesisht shtrihen nga veriperëndimi në jugperëndim. Në kuadër të analizës së mangësive janë përdorur të dhënat sipas vendeve të cilët nuk kanë ofruar kurrfarë informacionesh biogeografike, por kanë mundësuar analizat e nevojshme dhe krahasimin e sistemeve ekzistuese të zonave të mbrojtura.

Analiza e mangësive bazohet në tre grupe kryesore të dhënash: orientimi hapësinor i habitateve të ndryshme, shpërndarja e elementeve të biodiversitetit dhe hartografimi i zonave të mbrojtura ekzistuese. Llojet dhe habitatet e caktuara të cilat nuk janë të përfaqësuara sa duhet në zonat e mbrojtura trajtohen si “mangësi”. Për këtë qëllim, si “mangësi” janë përcaktuar ato raste në të cilat më pak se 10% e sipërfaqes (kufiri sipas IUCN-ës) së një lloji apo habitati është përfaqësuar në zonat e mbrojtura. Llojet dhe habitatet të cilat nuk janë fare të përfaqësuara janë konsideruar si “mangësi totale”. Llojet dhe habitatet e përfaqësuara me më shumë se 10% në zonat e mbrojtura janë konsideruar si “të mbuluara”.

Në nivelin rajonal, janë identifikuar 157 elemente të caktuara të biodiversitetit. Analiza ka treguar që pragu i sipërfaqes së përfshirë brenda zonave të mbrojtura, vendosur nga IUCN-ë, nuk është realizuar në asnjë prej vendeve të analizuara.

Analiza e secilit elementeve të caktuara të biodiversitetit tregon se:

në Bosnje-Hercegovinë

Sipërfaqja më pak e mbrojtur në rajon është Bosnje - Hercegovina. Vetëm 1'083km² (2.63%) të sipërfaqes brenda këtij ekorajoni është aktualisht e mbrojtur. Prej 111 elementeve të cilat janë identifikuar në këtë vend, 79 (71.2%) kanë treguar mangësi, ndërsa 21 (18.9%) mangësi totale. Vetëm 11 elemente (9.9%) mund të trajtohen si të mbuluara në mënyrë adekuate brenda zonave të mbrojtura. Mangësitë paraqiten njëllor për të gjitha grupet e elementeve të analizuar. Në pjesën e vogël bregdetare të Bosnjës -Hercegovinës nuk ka zona të mbrojtura detare.

në Kroaci

Në Kroaci janë identifikuar gjithsej 133 elemente të biodiversitetit. 78 elemente (58.6%) janë të mbuluar në mënyrë adekuate në zonat e mbrojtura, 52 (39.1%) janë identifikuar si mangësi, ndërsa 3 (2.3%) si mangësi totale. Sipas rezultateve, sistemi i zonave të mbrojtura tokësore në Kroaci duhet të konsiderohet si efikas për mbrojtjen e biodiversitetit. megjithatë, janë vërejtur disa mangësi të rëndësishme. Sistemi Kroat i zonave të mbrojtura në mënyrë adekuate mbulon zonat tokësore në lartësitë e mëdha, ndërsa ultësirat dhe zonat bregdetare (ndërmjet 0 dhe 600m lartësi mbidetare) nuk janë të mbuluara në mënyrë adekuate. Kjo gjithashtu vlen për mangësitë të cilat hasen kryesisht tek elementet e biodiversitetit që gjenden në ultësirë. Pyjet e përherbleritë të zonave bregdetare dhe zonave të larta malore janë të mbuluara në mënyrë adekuate. Pyjet e zonave të ulëta bregdetare nuk janë. Fushat karstike, të cilat janë të shpërndara nëpër tërë vendin dhe janë të një rëndësie vitale për biodiversitetin, nuk janë të mbuluara në mënyrë adekuate në zonat e mbrojtura. Mangësitë janë vërejtur tek hardhucat, veçanërisht tek llojet të cilët paraqiten në zonat më të ngrohta të ultësirave. Gjithashtu janë identifikuar mangësi të shumta lidhur me peshqit e ujërave të ëmbla, prej të cilëve shumica janë endemike.

në Mal të Zi

Në Mal të Zi janë identifikuar gjithsej 109 elemente, prej të cilëve 60 (55%) rezultojnë si mangësi, 15 (14%) si mangësi totale, ndërsa 34 mund të konsiderohen si të mbuluara në mënyrë adekuate brenda zonave të mbrojtura. Pak më shumë se 1000km² (6.2%) të sipërfaqes tokësore të vendit, që i përket Harkut Dinarik, është e mbrojtur. Edhe pse shumica e zonave të mbrojtura gjendet në ultësira, shumë elemente të ultësirave tregojnë mangësi. Kjo, për arsye se liqenet dhe ligatinat zënë një pjesë të madhe të sistemit të zonave të mbrojtura. Mangësitë paraqiten njëllor në të gjitha grupet e elementeve të analizuar. Vetëm elementet e zonave të larta malore janë relativisht mirë të mbuluara në zonat e mbrojtura. Në Mal të Zi nuk ekzistojnë zona të mbrojtura detare. Duhet të theksohet që Parku Kombëtar Prokletije i Malit të Zi është krijuar pas fillimit të kësaj analize dhe nuk është përfshirë në të. Ky park do të përmirësojë dukshëm sistemin e zonave të mbrojtura në Malin e Zi. .

në Shqipëri

Në Shqipëri janë identifikuar 97 elemente të biodiversitetit, prej të cilëve 38 (41.2%) janë identifikuar si mangësi, ndërsa 5 (5.2%) si mangësi totale. 54 elemente (53.6%) janë mbuluar në mënyrë adekuate brenda zonave të mbrojtura, çka përbën gati 1'280km² (9.86%) të pjesës tokësore të Shqipërisë përfshirë në Harkun Dinarik. Shumica e zonave të mbrojtura gjendet në ultësirë. Në kohën e përfundimit të analizës së mangësive, në Shqipëri nuk ka pasur asnjë zonë të mbrojtur detare.

në Slloveni

Zonat e mbrojtura të Sllovenisë nuk mbulojnë tërësisht elementet e caktuara të biodiversitetit. Prej gjithsej 85 elementesh të identifikuar në Slloveni, vetëm 15 (17.6%) janë të mbuluar në mënyrë adekuate në zonat e mbrojtura, 68 (80%) elemente rezultojnë si mangësi, ndërsa 2 elemente (2.4%) konsiderohen si mangësi totale. Mangësitë paraqiten njëllor në të gjitha grupet e elementeve të analizuar.

Në të ardhmen

Analiza ka treguar që numri i zonave të shpallura si të mbrojtura në Harkun Dinarik është i pamjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen adekuate të biodiversitetit në rajon. Kufiri prej 10% të sipërfaqes tokësore të mbrojtur sipas IUCN-së është realizuar vetëm në zonat tokësore në Kroaci. Zonat e mbrojtura detare në tërë rajonin janë mjaft larg këtij kufiri.

Bosnjë - Hercegovina, me rolin e saj qendror si lidhëse e biodiversitetit në pjesën veriore dhe jugore të Harkut Dinarik, pothuajse nuk ka një sistem të zonave të mbrojtura me korridoret përkatëse. Mungesa e të dhënave adekuate nxjerr në pah nevojën për investime në të ardhmen në kryerjen e inventarizimeve në terren për një vlerësim sa më të plotë të biodiversitetit të zonës.

Karakteristikat gjeografike të Harkut Dinarik tregojnë që ndryshimet klimatike të parashikuara do të ndikojnë seriozisht në rajon. Temperaturat e larta me periudha më të gjata thatësire do të shkaktojnë çrregullime në ekosistemet natyrore, me zhdukjen e popullatave dhe llojeve. Si rajon të cilin e karakterizon larmia e veçantë gjeomorfologjike, gjithashtu priten ndryshime në shpërndarjen në lartësi të llojeve dhe habitateve. Ndryshimet e klimës, së bashku me zhvillimin e infrastrukturës, do të krijojnë (janë duke krijuar që tani) kushtet e volitshme për futjen dhe aklimatizimin e llojeve të reja të huaja dhe invazive të kafshëve dhe bimëve. Ndryshimet klimatike gjithashtu do të ndikojnë edhe në ekologjinë detare. Ndikimi i ndryshimeve të temperaturës në popullatën e fitoplanktoneve - si prodhuesit primar të biomasës – do të shkaktojë ndryshime të njëpasnjëshme në të gjitha nivelet e zinxhirit ushqyes.

Përfundimet

Me më pak se 3% të sipërfaqes të mbuluar në mënyrë adekuate nga zonat e mbrojtura, Bosnjë-Hercegovina – e cila ka rolin qendror në lidhjen e biodiversitetit – duhet urgjent të krijojë një sistem të zonave të mbrojtura. Biodiversiteti në zonat e ulëta në Mal të Zi dhe Shqipëri nuk është i mbrojtur në mënyrë adekuate, kryesisht për shkak të pjesës së madhe të një ekosistemi në sistemin e zonave të mbrojtura (Liqeni i Shkodrës dhe lagunat bregdetare në Shqipëri). Në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë, ultësirat nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në sistemet e zonave të mbrojtura, ndërsa habitatet në lartësitë më të mëdha në tërë rajonin mund të konsiderohen si të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Mangësia më e madhe i takon habitateve në lartësitë mbidetare ndërmjet 200 dhe 1400 m të cilat, së bashku me ultësirat, i nënshtrohen presioneve më të mëdha të njeriut.

Në nivelin rajonal, shumica e llojeve të pyjeve nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Në mënyrë adekuate janë të përfaqësuar vetëm pyjet gjethembajtëse dhe shkurret, pyjet termofile të ahut, pyjet e zonave bregdetare me frashër, dushkajat si dhe shkurretat me kërkë. Livadhet malore ("rudine"), livadhet termofile dhe fushat karstike me ujëra sipërfaqësore janë identifikuar si mangësi. Habitatet e tjera tokësore janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në zonat e mbrojtura. Biodiversiteti i shpellave është pak i përfaqësuar në sistemet e zonave të mbrojtura. Për përcaktimin e vlerave të plota të këtij komponenti të biodiversitetit, i cili është me vlerë të jashtëzakonshme për tërë rajonin, është i nevojshëm një hulumtim më i gjerë dhe i përqendruar.

Zonat malore në thellësi të territorit janë veçanërisht të pasura me gjitarë të vegjël. Për këta element në tërë rajonin janë vërejtur mangësi konstante. Pikat e nxehta më të rëndësishme për zvarranikët gjenden përgjatë bregdetit Adriatik, në të cilin më së shumti ndikon klima e ngrohtë dhe e thatë mesdhetare. Mangësi janë vërejtur në shumicën e ishujve. Zonat me larminë më të madhe të llojeve të amfibëve janë vërejtur në pjesën qendrore Dinarike të Sllovenisë, në Kroacinë veriore dhe në malet e Bosnjë-Hercegovinës lindore, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Mangësitë janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në tërë rajonin.

Hartat e detajuara të shpendëve folezues nuk kanë qenë në dispozicion të analizës. Është analizuar rëndësia e fushave karstike për popullatën e shpendëve shtegtare. Është zbuluar që, vetëm në Slloveni, këto habitate jashtëzakonisht të rëndësishme dhe forma karakteristike të peizazhit janë të mbrojtura në mënyrë adekuate. Sërish, mangësia më e madhe edhe në këtë rast është vërejtur në Bosnje - Hercegovinë, ku janë të mbrojtura në mënyrë adekuate vetëm tre zona të rëndësishme për shpendët. Në nivelin rajonal, zonat e rëndësishme për shpendët janë të mbrojtura.

Zona të pasura me peshq të ujërave të ëmbla janë identifikuar në sistemet e lumenjve në Dalmaci dhe Bosnje - Hercegovinën jugore, përkatësisht në lumenjtë Krka, Cetina dhe Neretva. Të gjitha zonat e identikuara janë nën një presion të madh të veprimtarive të njeriut. Në nivelin rajonal, të gjitha zonat më të rëndësishme të peshqve të ujërave të ëmbla janë të nën përfaqësuar në sistemet e zonave të mbrojtura ekzistuese.

Mangësitë më të mëdha në mbrojtjen e gjitarëve të mëdhenj janë identifikuar në Slloveni dhe Bosnje-Hercegovinë, ku asnjë lloj nuk është i mbuluar në mënyrë adekuate. Infrastruktura e planifikuar do të fragmentojë edhe më shumë popullatat e mishngrënësve të mëdhenj.

Për sa i përket biodiversitetit detar, të dhënat jo të mjaftueshme mbi ekosistemet detare në tërë zonën e projektit tregojnë që nevojiten studime thelbësore për të plotësuar mungesën e informacioneve. Në Kroaci, zonat e mbrojtura detare mbulojnë më pak se 3% të sipërfaqes. Në Mal të Zi dhe Shqipëri nuk ekzistojnë zona të mbrojtura detare. Edhe pse zonat e mbrojtura detare në Kroaci nuk janë të mjaftueshme, është zbuluar se disa nga elementet e identifikuar në to janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Habitatet bregdetare janë të mbuluara në mënyrë adekuate në zonat e mbrojtura tokësore.



Përse jemi këtu.

Misioni i WWF-it është të ndalojë degradimin e mjedisit natyror të planetit dhe të ndërtojë një të ardhme në të cilën njerëzit jetojnë në harmoni me natyrën.

